

A photograph of chess pieces on a green board, with a knight in the foreground and other pieces in the background, all slightly out of focus.

BUSINESS CHALLENGE COMPETITION

4TH EDITION 2024

When digital transformation is done right, it's like a caterpillar turning into a butterfly, but when done wrong, all you have is a really fast caterpillar.

George Westerman



PËRMBAJTJA

- 03 Rreth B4Students
- 04 Rreth Business Challenge Competition
- 05 Prezantimi i Sfidës së Biznesit
- 07 Letër nga CEO
- 08 On Solution

RRETH

B4STUDENTS

B4Students është program i dedikuar për studentët në Shqipëri me fokus zhvillimin profesional, punësimin dhe vetëpunësimin e tyre, me mbështetjen e Fondacionit Mane në kompanitë e Grupit BALFIN.

Programi është i ndërtuar në 4 komponentë kryesorë:

SIPËRMARRJE

ORGANIZIMI I KONKURISIT TË IDEVE TË BIZNESIT, SI DHE I SFIDAVE TË BIZNESIT.

PRAKTIKA PROFESIONALE

KRIJIMI I MUNDËSIVE PËR ZHVILLIMIN E PRAKTIKËS PROFESIONALE NË SHOQËRITË E GRUPIT BALFIN.

KLUBET SOCIALE

MBËSHTETJA E PROPOZIMEVE PËR PROJEKTE SOCIALE ME IMPAKT POZITIV NË KOMUNITET.

FUQIZIMI I UNIVERSITETEVE

VLERËSIMI I NEVOJAVE TË IAL-VE PUBLIKE PËR INVESTIME INFRASTUKTURORE.

B4Students u prezantua në maj 2021. Regjistrimi i studentëve në program është i mundur nëpërmjet plotësimit të formularit online në linkun:

bit.ly/iamb4students

RRETH BUSINESS CHALLENGE COMPETITION

Konkursi i Sfidave të Biznesit, organizuar nga programi B4Students, në bashkëpunim me kompani të Grupit BALFIN, është një aktivitet i dedikuar për studentët të cilët konkurrojnë me propozimet e tyre për zgjidhjen e problematikave reale të biznesit.

Synimi kryesor i këtij aktiviteti është të nxisë inovacionin dhe mbështesë rritjen profesionale të studentëve në Shqipëri të cilët duan të zhvillojnë aftësitë e tyre digjitale në zgjidhjen e problemeve, të menduarin kritik, dhe planifikimin strategjik.



KRITERET E PJESËMARRËSVE

Vijimi i studimeve të larta



LINKU I REGJISTRIMIT

bit.ly/bcc-apply-now



DËRGIMI I ZGJIDHJES

hello@b4students.com

* Në konkurs mund të marrësh pjesë i vetëm ose në skuadër (deri në 3 anëtarë).

DATA TË RËNDËSISHME

16 shkurt 2024

hapja e thirrjes për sfidën e Onsolutions

01 mars 2024

afati për regjistrim dhe dërgimin e zgjidhjes

08 mars 2024

vlerësimi i zgjidhjeve dhe përzgjedhja e finalistëve

11-15 mars 2024

prezantimi i zgjidhjeve dhe përzgjedhja e tre fituesve

Në formulimin e zgjidhjes inkurajohet të jeni krijues. Vini re! Një strategji e mirë duhet të jetë në përputhje me fushën e aktivitetit të kompanisë, e ekuilibruar nga ana financiare, si dhe e qëndrueshme në lidhje me vazhdimësinë e biznesit.


KRITERET E VLERËSIMIT

Kreativiteti i zgjidhjes

Dobishmëria e zgjidhjes

ÇMIMET PËR FITUESIT


- Shpërblim monetar (vendi 1 - 300 €; vendi 2 - 250 €; vendi 3 - 200 €)
- Kurs profesional online falas, me përzgjedhje nga studenti (Coursera, etj)
- Ofertë për praktikë profesionale me mundësi punësimi në On Solutions dhe kompani të Grupit BALFIN.



SFIDA E ON SOLUTIONS



Cilat janë mënyrat më efektive për të rritur pjesëmarrjen e klientëve në program përmes aplikacionit Happy?



Studenti, sipas preferencës, mund të trajtojë një ose dy prej nënsfidave të propozuara:

- 1 Cilat janë mënyrat më efektive për të nxitur klientët të jenë çdo ditë aktivë në Happy (ose elemente të rinj që sot nuk janë në aplikacion)?
- 2 Si mund të edukojmë klientët të përdorin kartën digjitale në vend të asaj fizike, pasi shumë klientë nuk janë të familjarizuar me kartën digjitale?

STRUKTURA E ZGJIDHJES



UDHËZIME TË TJERA

- Zgjidhja përgatitet dhe dorëzohet nga studentit në format PowerPoint.
- Rekomandohet që studentit të citojë burimin e informacionit kur është i huazuar.
- Dokumenti përfundimtar emërtohet: BCC_Ed_4_Emër Mbiemër
- Zgjidhja dërgohet me email në balfin4students@gmail.com



Aida Velaj

Chief Executive Officer OnSolutions

LETËR NGA CEO

Të dashur studentë,
Uroj që kjo letër t'ju gjejë mirë dhe plot energji për studimet tuaja akademike!

Kam kënaqësinë të ndaj me ju faktin se On Solutions është kompania e përzgjedhur nga B4Students për edicionin e katërt të Konkursit të Sfidave të Biznesit. Ky është një aktivitet i rëndësishëm, dedikuar studentëve me fokus nxitjen e inovacionit dhe zgjidhjen e problemeve duke përdorur aftësitë digjitale, të menduarin kritik dhe planifikimin strategjik.

On Solutions është një nga kompanitë më të reja të Grupit BALFIN, e themeluar në vitin 2020, e specializuar në shërbime si programi i besnikërisë së klientit, kërkimi i tregut, menaxhimi i eksperiencës dhe gjithë operacioneve të klientit në çdo kanal si social, media, dyqan, telefoni, shitje online dhe më gjerë.

Me klientin në fokus, qëllimi dhe ambicia kryesore e kompanisë është të jetë lider në treg, si në terma të cilësisë së shërbimit ashtu edhe të inovacionit. Inovacioni nuk është thjesht një koncept për ne, por elementi kryesor dhe katalizatori që do të revolucionarizojë industrinë dhe eksperiencën e klientit.

Çdo përparim i madh në historinë njerëzore ka qenë rezultat i të menduarit novator, ideve të guximshme dhe konsistencës e vendosmërisë për ti bërë realitet ato. Si drejtuese e një kompanie inovatore, ju drejtohem si studentë dhe e ardhmja e këtij vendi, të jeni kuriozë, të guxoni të mendoni në mënyrë krijuese dhe përtej limiteve, duke mos e nënvleftësuar asnjëherë energjinë tuaj, njohuritë, kreativitetin dhe potencialin që keni brenda vetes suaj.

Ne kemi nevojë për këndvështrimin tuaj, për t'u bashkuar me ne në misionin tonë për të inovuar dhe për të krijuar një të nesërme më të mirë.

Ju sfidoj të përqëndroni intelektin dhe imagjinatën tuaj për të identifikuar mënyrat më krijuese në zgjidhjen e një prej sfidave tona të momentit, asaj të përmirësimit të eksperiencës së klientëve në aplikacionin Happy.

Cilat janë mënyrat më efektive për të rritur pjesëmarrjen e klientëve në program përmes aplikacionit Happy?

- Cilat janë mënyrat më efektive për të nxitur klientët të jenë çdo ditë aktivë në Happy (ose elemente të rinj që sot nuk janë në aplikacion)?
- Si mund të edukojmë klientët të përdorin kartën digjitale në vend të asaj fizike, pasi shumë klientë nuk janë të familjarizuar me kartën digjitale?

Presim me padurim të shohim idetë tuaja.
Suksese të gjithëve!

RRETH ON SOLUTIONS

On Solutions menaxhon programin më të madh të besnikërisë në Shqipëri, Happy, me pothuajse **+490.000** anëtarë që shpërblehen çdo vit.

Happy Program është e vetmja skemë multi-brand në Shqipëri me pjesëmarrjen e kompanive lider në Shqipëri si: Spar, Neptun, Jumbo, Fashion Group Albania, Tirana Bank dhe të tjera për t'u bashkuar së shpejti.

Kompania ka ekspertizë në shërbimet e Kujdesit ndaj Klientit, duke ofruar një përvojë të nivelit të lartë ndaj klientëve në baza ditore.

On Solutions është gjithashtu përgjegjëse për të kryer kërkime, sondazhe dhe për të matur kënaqësinë e klientit. Në OnSolutions, ne kemi klientin në qendër të çdo vendimi, duke synuar optimizimin e vazhdueshëm të përvojave të klientit.



BURIME PËR INFORMACION

 <https://onsolutions.al/> <https://balfin.al/>



www.b4students.com hello@b4students.com



E Drejta e Autorit © 2024 nga B4Students

Të gjitha të drejtat janë të rezervura. Informacioni i prezantuar në këtë material është përgjegjësi e programit B4Students. Materiali është përgatitur në funksion të Konkursit të Sfidave të Biznesit dhe nuk mund të përdoret si referencë dhe të publikohet nga palë të tjera, pa aprovim paraprak.